



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.226/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Kujtim Pasuli - kryesues, Hidajete Gashi Alaj dhe Ramush Bardiqi - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidatit të pavarur për kryetar të Komunës së Vushtrrisë, Shaban Miftari, e paraqitur kundër Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive për ditën e zgjedhjeve, në ditën e votimit për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me 17.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET E PABAZUAR ankesa ZL.Anr.226/2025, e datës 16.10.2025, e parashtruar nga kandidatit i pavarur për kryetar të Komunës së Vushtrrisë, Shaban Miftari, e paraqitur kundër Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive për ditën e zgjedhjeve, në ditën e votimit për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datën 16.10.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën e kandidatit të pavarur për kryetar të Komunës së Vushtrrisë, Shaban Miftari, të dorëzuar përmes postës me datë 13.10.2025, me të cilën pretendon se me datë 10.12.2025 ne qendrat e votimit ne Sh.F.M.U. "Migjeni" ne Stanovc te Eperm dhe ne Sh.F.M.U "Nazmi Zhegrova" ne Stanovc te Poshtem, është vërejtur keqpërdorimi i votave nga komisioneret. Persona qe kane votuar ne favor timin ne këto vendvotime pohojnë se votat e tyre nuk janë regjistruar sipas vullnetit te tyre dhe dyshohet për manipulim ne favor te subjekteve tjera politike. Kërkojë qe PZAP të bëjë verifikimin e kutive të votimit dhe të ndërmarr masat përkatëse ligjore. Qytetaret qe kanë votuar kanë vërejtur se është keqpërdorur votat e tyre për subjektet tjera politike, emrat e tyre janë Ismajl Vojvoda dhe Jeton Klinaku.

Në përgjigjen në ankesë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me datë 17.10.2025, ka deklaruar se: KQZ, pas pranimi të kërkesës së PZAP, menjëherë ka kontaktuar me KKZ e komunës së Vushtrrisë, duke pranuar përgjigjet dhe sqarimet si në vijim:

"KKZ ditën e zgjedhjeve nuk ka pranuar ndonjë thirrje nga ndonjë ankues në atë Qendra të Votimit. Po ashtu, KKZ thekson se nga votat e pranuar nga Formularët e Subjekteve politike për Kryetar Komune të Vendvotimit në këto dy QV për të njëjtin kandidat (ankues), janë të njëjta me rezultatet të cilat janë verifikuar dhe regjistruar në Formularët e Subjekteve për Kryetar Komune pa asnjë dallim nga vendvotimi dhe verifikimi në QKN. Gjithashtu, ju njoftojmë se lidhur me rastin në fjalë, nuk është raportuar për ndonjë parregullsi në dhomën operative të KQZ-së në ditën e zgjedhjeve, më datë 12.10.2025. KQZ, ju njofton se i gjithë materiali zgjedhor duke përfshirë edhe kamerat e sigurisë, janë dorëzuar nga QKN në

Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve -QNR, dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet drejtësisë.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjeve në ankesë, gjeti se:

- Ankesa është e pabazuar

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjeve në ankesë të paraqitur nga KQZ-ja, vlerësoj se pretendimet e kandidatit të pavarur për kryetar të Komunës së Vushtrrisë, Shaban Miftari, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nuk është arritur që të vërtetohen se ka pasur parregullsi në qendra të votimit të cekura në ankesë dhe se janë bërë keqpërdorimi i votave nga komisioneret. Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se parashtresuesi i ankesës nuk ka mbështetur pretendimet e tij me prova, rrjedhimisht nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara, edhe pse me kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin dhe në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave në qendrat e votimit të komunës së Vushtrrisë.

Po ashtu edhe nga përgjigja e KQZ-së, vërehet se nuk qëndrojnë pretendimet e parashtuara me ankesë sepse nuk është pranuar asnjë raport, informatë, apo shprehje të pakënaqësive eventuale nga vëzhguesit e partive politike dhe vëzhguesit ndërkombëtar as në ditën e zgjedhjeve, gjatë procesit të numërimit të votave për kandidat në QKN, dhe as Formularët e rezultateve të subjekteve politike (FRS) dhe Formularët e rezultateve të kandidatëve (FRK) të ofruara në përgjigje nuk vërehet asnjë shënim apo vërejtje në Librin e Shënime në QKN, në Komunën e Vushtrrisë.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: "Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse", Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesa dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtresuesi i ankesave nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e theksuara si më lartë.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 par. 3, neni 118 par.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr.226/2025 më datën 17.10.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.